



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 9-3/2019 (JR)
Nr. 9-3/2019/2 regj.

Tiranë, më 4 . 3 .2026

SHPALLJE
E
NJOFTIMIT PËR GJYKIMIN E ÇËSHTJES NË DHOMË KËSHILLIMI

Nëpërmjet kësaj shpalljeje, Kolegji i Posaçëm i Apelit, bazuar në nenin 65, pika 1 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, njofton të gjithë personat e interesuar, se ditën e martë, më datë **24.03.2026, ora 12:50**, do të shqyrtohet në dhomë këshillimi, çështja me numër regjistri (JR) 9-3/2019, datë 06.02.2023, si dhe kërkesat me nr. 203/54 prot., datë 24.05.2023 dhe me nr. 1290 prot., datë 20.12.2024, që i përkasin kërkueses **znj. Entela Prifti**, për rishikimin e vendimit (JR) nr. 34, datë 02.12.2019 të Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

Seanca në dhomë këshillimi do të zhvillohet në selinë e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në adresën Bulevardi “Dëshmorët e Kombit” nr. 3, Tiranë.

Trupi Gjykses, përbëhet nga gjyqtarët:

Kryesuese	Albana Shtylla
Relatore	Natasha Mulaj
Anëtar	Sokol Çomo
Anëtare	Ina Rama
Anëtare	Rezarta Schuetz

Bazuar në nenin 49, pika 2 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, palët kanë të drejtë të paraqesin deri 5 ditë para seancës së shqyrtimit të çështjes, parashtrime me shkrim, lidhur me shkaqet e ngritura në kërkesë. Bazuar në nenin 482, paragrafi i tretë i Kodit të Procedurës Civile, kjo shpallje bëhet të paktën 15 ditë përpara datës së shqyrtimit, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, si dhe me njoftim individual në adresën elektronike alternative të kërkuetit. Ky njoftim bëhet gjithashtu edhe në faqen e internetit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

KRYESUESE E TRUPIT GJYKUES
GJYQTARE

ALBANA SHTYLLA

